



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 2587/ Prot.

Tiranë, më 25.10.2025

VENDIM

Nr. 326, Datë 23.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI TË PROKURORIT
ANTONETA SEVDARI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungese)
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar (në mungese)
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni të prokurorit Antoneta Sevdari”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues 2587 prot., datë 22.10.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi Relatorin Arta Mandro, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Pranë Këshillit është administruar me Nr. 2523 prot., datë 14.10.2025, Kërkesa e magjistratit Antoneta Sevdari, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt kryerjen e veprimtarisë jashtë funksionit të prokurorit, me pagesë.
2. Siç rezulton nga kjo kërkesë, nga Këshilli i Europës është propozuar angazhimi i prokurores Antoneta Sevdari në cilësinë si Eksperte në Trajnimin me temë *“Raportimi i saktë i Drejtësisë, standardet profesionale në raportimin për çështjet ligjore dhe gjyqësore”*. Aktiviteti në fjalë do të zhvillohet në datat 31 Tetor dhe 1 Nëntor¹ 2025.
3. Bashkëlidhur kërkesës për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksioni ndodhet Vërtetimi i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku jepet informacion mbi ngarkesën e punës së kërkueses dhe vlerësimi se, angazhimi në veprimtari jashtë funksionit si më sipër nga ana e prokurores nuk ndikon në ushtrimin e ndjekjes penale nga zyra e prokurorisë.
4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstaton se, prokurorja Antoneta Sevdari nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
5. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nga prokurorja Antoneta Sevdari nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së saj.
6. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:
 - është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
 - nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohet sipas ligjit.
 - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
 - nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.
7. Bazuar në sa më sipër, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli vlerësoi të bazuar miratimin e kërkesës së prokurores Sevdari për kryerjen e veprimtarisë jashtë funksionit, si Eksperte në Trajnimin me temë *“Raportimi i saktë i Drejtësisë, standardet profesionale në raportimin për çështjet ligjore dhe gjyqësore”*,

¹ Sipas kalendarit është ditë e Shtunë

që do të zhvillohet në datat 31 Tetor dhe 1 Nëntor 2025, dhe që organizohet nga Këshilli i Europës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, pika 1, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Antoneta Sevdari, si Eksperte në Trajnimin me temë “Raportimi i saktë i Drejtësisë, standardet profesionale në raportimin për çështjet ligjore dhe gjyqësore”, që do të zhvillohet në datat 31 Tetor dhe 1 Nëntor 2025, që organizohet nga Këshilli i Europës.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe prokurori Antoneta Sevdari.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 23.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ZV/KRYETAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erion Fejzulla